37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes

së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [gjuha e procedurës - shqipe].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës: <b>12.229.87 €</b> me afat të vlefshmërisë prej <b>150</b> ditë
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	10.2	Ofruesi i Punëve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetetin Kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i Punëve, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij. Ofruesi i Punëve do të jetë tërësisht përgjegjës për dëmet eventuale në pronën,. Çdo dëmtim i shkakuar do të korrigjohet nga ofruesi i Punëve në shpenzime të veta. Ofruesi i Punëve duhet të sigurojë që i gjithë stafi i tij, i cili kryen shërbimet, janë të siguruar plotësisht dhe kanë përgjegjësinë për ndonjë dëm nga ta.
	10.3	Kontraktori është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke : - bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt - duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve, - duke u siguruar në përdorimin e drejt të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët, - duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si dhe rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë si : rrobe pune, helmata, këpucë adekuate

		<p>varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse, dorëza pune ...etj.</p> <p>varësisht nga natyra e punës të angazhoj punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme</p>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(d) dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i></li> <li>(ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i></li> </ul> </li> </ul> <p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre</p>
Programi	12.1	<p>Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës dhe ta dorzojnë në zyrën e prokurimit <b>Kryetari i komunës</b>, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranim teknik me një Vendim tjetër . Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.</p>
	12.2	<p>Periudha për Programin e azhurnuar <b>sipas planit dinamik</b>.</p> <p>Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për kualitetin e punimev{për eliminim e të metave} në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës</p>

Fillimi i punëve	17.1	<p>Data e fillimit do të jetë</p> <p>Data e fillimit do të jetë 3 – 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryerësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezentuar në dosje të tenderit. Nëse pas urdhërit prej tre ditëve nuk paraqitet Ixhinieri i OE në vendpunishte, Komuna ka te drejten t'i jap urdhresen e fundit per nderprerje te kontratës.Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me te domosdoshme ne vendpunishte/</p>
	17.2	<p>Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <b>[120]</b> ditë.</p> <p><b><i>Nga fillimi i punimeve</i></b></p>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë</p> <p><b>Nëse Ofruesi i punëve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë,Autoriteti kontraktues,pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë,për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfudnimit,t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë..</b></p> <p>Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkallim të ditëve. Nëse ka tejkallim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim dhe do të jetë përgjegjës për mos futje në penale.</p>
Regjistri i punës	20.1	<p><b>20.1</b> Një regjistër i punës do të, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:</p> <p>a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne</p>



		<p>Kontraktuesit;</p> <p>b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.</p> <p><b>20.2</b> Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si punë në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopjetë shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.</p> <p><b>20.3</b> Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur</p>
Inspektimi dhe testimi	22.1	<p>Menaxheri i Projektit është <b>Autoriteti Kontraktues do të emëroj “Menaxherin e Projektit”, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Organi mbikqyrës sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Organi mbikqyrës nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.</b></li> </ul> <p><b>-Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.</b></p> <p><b>-Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.</b></p>
Parapagimi	26.1	<p>Shuma e Parapagimit është: <b><i>Parapagim nuk do të ketë</i></b></p>

Mbajtja e Parasë	27.1	<b>Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës së kontratës do jet sigurim bankar për garantinimin e punimeve</b>
Shkaqet për kompensim	30.	<p>Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:</p> <p>(a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit</p> <p>(b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.</p> <p>(c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.</p> <p>(d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.</p> <p>(e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.</p> <p>Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit</p>
Konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit	30.5	<p>30.6 AK do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në situatat e mëposhtme:</p> <p>a) Në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK dhe/ose kërkon që AK të shkaktoj shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës së tillë; ose</p> <p>b) Për shkelje të kontratës së nënshkruar shumë punëtorë, nën-kontraktues dhe/ose furnizues kanë mbetur të pa-paguar.</p> <p>30.7 AK para se të filloj procedurën e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit AK <b>duhet të informoj</b>, me shkrim, OE për çdo dështim të supozuar me kontratë dhe të jep OE kohë të mjaftueshme për korrigjim të dështimeve të tilla. Dështimi i OE për të korrigjuar, në kohë, dështime të tilla të supozuara do të rezultojë në procedurën e konfiskimi.</p> <p>30.8 Konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit, nuk e ndalon autoritetin kontraktues të kërkojë zhdëmtimin shtesë që rrjedhin nga kontrata dhe, po ashtu, nëse siguria e</p>

		<p>ekzekutimit është me vlerë më të lartë se dëmet nga shkelja, autoriteti kontraktues duhet t'i rik-thejë diferencën.</p> <p>30.9 Autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e performances në cilëndo nga format e përcaktuara në nenin 30.5 të këtyre rregullave dhe Udhëzuesi Operativ. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në nenin 30.5, do të konsiderohet e pavlefshme.</p> <p>Pavarësisht nga neni 63 i LPP-së, sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë i pakushtëzuar. Për qëllimet e mësipërme, fjala "pakushtëzuar" do të thotë një garanci e zbatueshme me kërkesë dhe se nuk duhet të ketë ndonjë kusht ose kërkesë për ndonjë dëshmi të përfshirë në sigurimin e ekzekutimit përveç një kërkesë që Autoriteti Kontraktues duhet të ofroj një dokument që tregon që ka ndodhur shkelje gjatë implementimit të kontratës. Si rrjedhojë nuk ka nevojë të mëtejshme që autoriteti kontraktues të vërtetojë shkeljen. Në mbështetje të nenit 63, paragrafi 5, të LPP, kërkesat për kualifikimin e lëshuesve të sigurimit të ekzekutimit, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit, do të jenë jo-diskriminuese, nuk do të kërkojnë nga lëshuesi që të ketë një biznes në një vend të veçantë, dhe në çdo rast do të kufizohet vetëm në kriteret që janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurimin e stabilitetit financiar dhe besueshmërinë e këtyre institucioneve.</p>
Mbikëqyrja	32.1	Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasësave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Punët shtesë	32.2	Nëse paraqitet nevoja: Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	32.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	32.4	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera, faturat, atestet për materialet e përdorura nëse ka, shkresat, fletët e ditarit të

		punës, arsyetimin për tejkalimin e ditëve kalendrike nëse ka, sigurimet, etj, në të kundërtën e marrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	32.5	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtari për rexhistrimin e pasurisë.
Hyrja në fuqi	33.6	Kontrata hynë në fuqi 3-5 ditë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe --- -Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve dhe një kopje të dorëzohet në zyrën e prokurimit. Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plani i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Informatë shtesë	33.7	Kontraktuesi e ka për obligim ta vendos PANON në hyrje dhe dalje të punishtës në madhësinë standarde, ku do të përfshihen, titulli i projektit, investuesit dhe punëkryerësi.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1095 ditë ose 3 vite Po ashtu për sigurimin e cilësisë së punëve, Operatori Ekonomik pas pranimit teknik duhet të ofrojë garancion bankar për sigurimin e punëve 10 % nga vlera e kontratës, në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do të sanohet në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të

		kundërtën pajtohet se AK ato dëme do ti sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do ti faturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Nese jane grup OE,kjo deklarate epet në emër të liderit të konzorciumit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet qe te zgjidhen ne mënyre miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës te Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës te prokurimit si dhe personave përgjegjës te autorizuar nge Kryersi i punimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës



"SB CONSTRUCTION" SH.P.K.  
Adresa: Rruga e Llapit, Milloshevë-Obiliq  
Tel: +383 (0) 44 261 444, +383 (0) 49 096 874  
email: sbconstruction@kmail.com



"SABA BELLÇA" DEGA NË KOSOVË  
Adresa: Rruga e Llapit, Milloshevë-Obiliq  
Tel: +383 (0) 44 301 444, +383 (0) 49 096 874  
email: sababellca.kosovo@gmail.com

## DEKLARATË PËR SPECIFIKACION

Udhëheqësi i konzorciumit: "SB CONSTRUCTION" SH.P.K. me adresë Milloshevë-Obiliq, me nr. të biznesit: 70527987 , për projektin me titullin:

Asfaltimi i rrugëve: Abdullah Qerkezi, Albert Rama, Hamdi Krasniqi, Aziz Zhilivoda, Prapashtica, Mentor Dervishaj, Çajupi

Numri i Prokurimit: OB614-18-3935-5-2-1

Të gjitha specifikat teknike për punët e ofruara nga konzorciumi jonë, përputhen plotësisht me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Udhëheqësi i konzorciumit:

"SABA BELLÇA DEGA NË KOSOVË"

Drilon Etemi



## **ANeks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

### **Pastrimi i terrenit**

Kjo pune parashihet pastrimin, largimin e mbeturinave, bimeve, largimi i ujit sipërfaqësor dhe nentokësor si dhe gjerave tjera të panevojshme brenda kufijve të punës përveç objekteve të tilla që janë caktuar të mbeten aty ose janë për t'u vendosur në pajtim me seksionet tjera të specifikacioneve. K.P do të vendosë kufijt e punës aty ku është e aplikueshme, K.P do të shënojë të gjitha drunjtë, shkuret, arat dhe gjerat tjera që mbesin aty. K.P do të mbrojë të gjitha gjerat e shënuara për të mbetur.

Të gjithë objektet sipërfaqësorë dhe të gjitha drunjtë, mbetjet, rrenjet dhe obstrukcionet tjera jo të shënuara do të pastrohen dhe/ose të hiqen nga rrenja. Përveç në zonat që do të mihen, gropat e mbetura dhe gropat e tjera nga të cilat obstrukcionet menjaherë duhet të mbushen dhe të ngjeshen deri në 100% të dendësisë maksimale të thate. Materialet e pastruara mund të zhvendosen në vende të specifikuara nga kontratuesit dhe të shpenzimet do të mbulohen nga K.P.

### **Punët e germimit në përgjithësi**

Të gjitha germimet, gjerësia dhe thellësia e kanalit, duhet të kryhen sipas detajeve të dhëna në pjesën e Vizatimeve. Para se të fillojë germimi por pasi që të janë larguar mbingarkesat, do të bëhet shejmi/kujimi i saktë i kanalit dhe kuota e terrenit.

Kryesisht dhe që do të germohet për këtë projekt është dhe i kategorisë së II dhe III. Trasa në tersi saj kalon në rrugë të fshatit (shtresë zhavori).

Germimi duhet të kryhet me eskavator (në rast nevojë edhe me dorë) dhe materiali i germuar të dërgohet në deponienë e caktuar nga O.M. Materiali që përseri do të përdoret për mbushje mund të vendoset në vende të caktuara përkoheqsisht, mirëpo nuk guxon të paraqet rrezik për banorët.

Në rastet ku thellësia e germimit kalon 1.5 m' K.P duhet të marrë masat e nevojshme për përkrashjen e mureve të kanalit ashtu që ato të mos jenë rrezik për punëtorët dhe banorët. Përkrashja të bëhet sipas metodave të njohura në praktikën ndërtimore. Në rast të paraqitjes së ujërave nentokësore K.P duhet të marrë masa për largimin e këtyre ujërave duke mos kërkuar mjete shtesë.

Gjatesia e potezës që germohet nuk guxon të jetë më e gjatë se sa që mund të mbulohet për një kohë të shkurtër (nuk do të germohet asnjë gjatësi e kanalit para se të arrijnë në terren gypat edhe fittingjet të cilat do të vendosen aty). Gjatesia e kanalit që do të germohet brenda ditës duhet që të aprovohet nga O.M dhe kjo gjatësi nuk guxon që të jetë e tillë që të rrezikojë jetën e banorëve.

Para fillimit të punëve të germimit K.P duhet që të verifikojë stabilitetin e objekteve për rreth zonës së germimit dhe të marrë përfaqësimin e O.M. Gjithashtu K.P duhet të interesohet dhe të sigurojë të dhëna të mjaftueshme për infrastrukturën nentokësore në mënyrë që të mos shkaktojë dëmtime të paparapra.

Nuk do të ketë pagesë të veçantë për germimet shtesë të cilat i bën K.P për lehtësimin gjatë konstruktiveve apo gjatë instalimeve të ndryshme.

Në rast të dëmtimeve nga pakujdesia gjatë kryerjes së punimeve nga ana e K.P, i njëjti duhet që të shpenzime të veta t'i mbulojë demet e shkaktuara.

Për llogaritë të kubaturës së vëllimit të germimit është marrë vëllimi i dheut i dalur nga dimensionet e para germimit (jo vëllimi i dheut të germuar në gjendje të shkruar)

### **Largimi i materialit të tepert**

Materiali i tepert që mbetet pas germimit duhet të transportohet dhe të deponohet në lokacion të caktuar nga O.M. Deponimi duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos paraqet rrezik për banorët.

Shpenzimet per transportin e materialit te tepert hyjne ne shpenzime te germimit.

## **Punet e dheut**

### **Germimi**

Ne pergjithesi eshte e parapare qe shtresat e rruges ekzistuese te rrafshohen me makineri te rende gryese (grejder) ndersa pjesa ku per shkak te zgjerimit te rruges duhet te behet germim me i thelle duhet qe te germohet dhe planifikohet sipas dimensioneve dhe thellesive te dhena ne pjesen e vizatimeve.

Dheu i tepert i grryer duhet qe te selektohet dhe perdoret ne pozicionet ku kerkohet mbushje me e madhe.

Pjesa e re me e gjere se pjesa ekzistuese e rruges duhet te gryhet me mire dhe te ngjeshet e te mbushet deri ne nivelin e rruges ekzistues me material te zgjedhur te germuar. Po ahtu rendesi e posaqme duhet ti kushtohet germimit dhe hapjese se kanaleve dhe pozitave ku do te vendosen tombina.

### **Mbushja**

Ne pjese te rruges ekzistues ku duhet te behet mbushja me material te ri duhet qe te i kushtohet rendesi ngjeshjes dhe se materiali i perdorur per mbushje duhet jete pa permajtje humusore. Materiali i grryer mund te pedoret duke u selektuar. Per arritje te shkalles me te mire te ngjeshjes rekomandohet edhe perdorimi i sasive te nevojshme te ujit me qellim qe te ngjeshjes me te mire. Bazamenti i ngjeshur i pergaditur per vendosjen e shtresave te tamponit duhet qe te ngjeshet dhe te dhe kerkohet qe shkalla e ngjeshmerise te arrije vleren prej 50MN/m<sup>2</sup> ne gjendje te thate. Pas çdo faze të punës të bëhet një kontroll i rrepet për modulën e deformimit me parametra të kërkuar më lartë.

## **Tamponit dhe asfaltit**

### ***Punimet e shtresave të tamponit***

Shtresat e tamponit do të vendosen me renditje dhe trashësi siq është e dhëne ne vizatimet përkatëse dhe siq eshte cekura më larte/poshtë.

Shtresa e parë nga materiali mbushes (material me përbamje gurore) vendoset rrafshimit me grejder te shtrese me pare te pergaditur dhe te ngjshur ne nivel perafersisht 40cm nga niveleta e projektuar me planifikim dhe kompaktimit të saj , që vendoset në shtresa jo më të mdha se 40cm. Trashesi e kesaj shtrese eshte konstante. Materiali i perdore nuk guxon te permaj materie organike dhe perqindje te kokrrizave me te medha ose me te vogla se ato te lejuara. Lakorja granulometrike e materialit duhet shtrihet brenda kufijve te lejuar per kete lloj te materialit. Kryesi i punimeve duhet qe te dorezoi atestet per perbejen dhe kualitetin e materialit te perdorur te organi mbikqyres. Materiali ne pergjithesi duhet te jete konfrom ndonjerit prej standardeve aplikative per kete lloje te puneve. Bazamenti i ngjeshur i pergaditur per vendosjen e shtresave te tamponit duhet qe te ngjeshet dhe te dhe kerkohet qe shkalla e ngjeshmerise te arrije vleren prej 70MN/m<sup>2</sup> ne gjendje te thate.

Shtresa e dyte ose finale e tamponit me trashësi d=10 cm dhe madhësi të kokrrave nga 0-31.5mm nga zhavori mirë i graduar. Trashesi e kesaj shtrese eshte konstante. Materiali i perdore nuk guxon te permaj materie organike dhe perqindje te kokrrizave me te medha ose me te vogla se ato te lejuara. Lakorja granulometrike e materialit duhet shtrihet brenda kufijve te lejuar per kete lloj te materialit. Kryesi i punimeve duhet qe te dorezoi atestet per perbejen dhe kualitetin e materialit te perdorur te organi mbikqyres. Materiali ne pergjithesi duhet te jete konfrom ndonjerit prej standardeve aplikative per kete lloje te puneve. Bazamenti i ngjeshur i pergaditur per vendosjen e shtresave te tamponit duhet qe te ngjeshet dhe te dhe kerkohet qe shkalla e ngjeshmerise te arrije vleren prej 80MN/m<sup>2</sup> ne gjendje te thate.

Shtresa e zhavorit me trashesi prej 10 cm duhet te planifikohet me saktësi deri ne ±2 cm.



Në çdo shtresë veç e veç pjesmarrja e fraksioneve më të imta se 0.063mm në material të ndërtuar nuk duhet të jetë më e madhe se 8%, ndërsa në deponi jo më tepër se 5%. Gjithashtu përmbajtëja e fraksioneve të hargjuara ose të zbrërthyer duhet të jetë jo më tepër se 7% nga masa e tërë.

Per gjate trases nga te dy anet duhen te punohen bankinat me gjersi prej 75 cm, ndersa nga ana e majt duhet te hapet kanali per largimin e ujrave, i cili ne vendet e caktuara zbrazet me ane te leshesave beton arme.

Ngjeshja e tamponit duhet të bëhet me mjete të rënda vibruse, ashtu që në shtresat e tamponit me provë të pllakës rrethore  $D=300\text{mm}$  të arrihet moduli i deformimit

*Para shtruarjes së tamponit duhet të bëhet ngjeshja e bazamentit (këmishza) duke arritur modulin e deformimit  $ME > 50\text{MN/m}^2$ , e mandej vendoset gjeotekstili  $300\text{ g/m}^2$  (kjo duhet te vendoset nga ana e investitorit).*

Është me rëndësi që shtresa e poshtme mbajtëse duhet gjithsesi të jetë e mbrojtur nga veprimi i rrezikshëm i ujit sipërfaqësorë. Që të arrihet kjo është e domosdoshme që niveli i kanaleve të hapura të jetë min 70cm nën nivelin e trupit të rrugës.

Vrejtëje :

Pas çdo faze të punës të bëhet një kontroll i rrepet për modulin e deformimit me parametra të kërkuar më lartë. Po ashtu kontolla duhet te behet edhe ne cdo 100 m' gjatesi te shtrese se shtuar duke shkua ne menyre "zig-zake"

### **Punimet me asfalt**

Vendosja e shtresave të asfaltit për shkak të llojit të ngarkeses dhe madhesis së qarkullimit të automjeteve në rrugë është bërë në këtë mënyrë.

Shtresa e parë nga asfalt-betoni 0/16 guri gelqeror me trashësi  $d=80\text{mm}$ .

Shtresa e asfaltit duhet të plotsojë sipas rregullave teknike:

Mesatarja e ngurtësimit..... $N > 2.2\text{kN/mm}$ .

Mesatarja e zbrasësirave.....në kufitë 3-6 %.

Mesatarja e rrjedhshmërisë..... $r=2-4\text{mm}$

Mesatarja e stabilitetit..... $Sk > 8.0\text{kN}$

Kompaktësia .....  $> 98\%$

Përqindja e bitumenit për shtresën e Asfalt betonit të sillet në kufijt: (5-8) %.

Agregati për asfalt beton duhet të përbëhet nga guri i pastër, i fortë, i qëndrueshëm dhe i shëndosh me kualitet uniform të granulave pa përmbajtje të organike, lym dhe materiale tjera të shkrifta.

Përzierja e agregatit për shtresë e asfaltit duhet të përbëhet nga përzierja e zallit natyror dhe materiali i thyer guror, dhe duhet te testohet për athezionin e tij me bitumen e poashtu të testohet edhe për vetit e bymimit duke zhytur mostrën sipas metodës së " testimit Marshall ".

Mbushja minerale duhet të jetë nga pluhuri i gurit të thyer i prodhuar nga thyerja e gurit të fortë dhe të qendrueshëm.

### ***Procedurat e shtruarja e asfaltit***

Makina për shtresën përfunduese duhet që të ketë mundësinë e shpërndarjes së përzierjes në trashësinë e dhënur , të jetë në gjendje që të lëshojë dhe shpërndaj përzierjen duke prodhuar një sipërfaqe të rrafshët dhe me tekstur uniforme në gjithë gjerësinë e shtruarjes.

Para fillimit të shtruarjes së përzierjes duhet që të bëhet stërpikja e bazës me emulzion të bitumenit me një sasi 0.30kg/m<sup>2</sup>.

Në vendet e ngushta dhe të vogla ku makina shpërndarëse nuk mund të hyjë shpërndarja e përzierjes mund të bëhet edhe me dorë.

Temperatura e përzierjes së asfaltit në kohën e shpërndarjes duhet të jetë 150 - 160°C, në varësi nga materiali lidhës.

Lidhjet duhet të prehen në këndë me vijë të drejtë, të lyhet me emulzion bitumeni para se të shtrohet traka e ardhëshme.

Menjherë pas shpërndarjes së përzierjes së asfaltit e njëjta duhet të ngjeshet me cilindra të ndryshëm të cilët veprojnë në mënyrë simultane. Është e domosdoshme që njëri nga këta cilindra të jetë cilindër me goma me peshë së paku 6 tona.

Skajet duhet të kompaktësohen - ngjeshen me kujdes të veçant dhe duhet të ekzekutohen në atë mënyrë që vija e skajit të jetë e drejtë dhe e saktë. Zgjerimet irregulare duhet të prehen.

Para se të shtrohet shtresa e re shtresa paraprake duhet të pastrohet me kujdes të veçant.

Për lidhje të mirë të shtresave bëhet lyerja e shtresës paraprake me emulzion bitumeni me sasi prej 0.2 kg/m<sup>2</sup>.

# PJESA IV E KONTRATËS: SIGURIMI I EKZEKUTIMIT



DEKLARATA E GARANTUESIT  
Sigurim Ekzekutim



Serial\ 070010150006761

Për **KOMUNA E OBILIQIT**  
(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)  
**DUKE PASUR PARASYSH QË**

**"SABA BELCA" Dega ne Kosovë**  
(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")  
ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull  
**i i rrugeve:Abdullah Qerkezi,Albert Rama,Hamdi Krasniqi,Aziz Zhilivoda,Prapashtica,Mentor Dervishi,**  
të dhënë me numrin e Prokurimit. **OB614-18-3935-5-2-1**  
(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;  
**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:  
**PËR KËTO ARSYE** vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej **€ 12,229.87**

**Dymbëdhjete mijë dhe Dy qinde dhe Njzet dhe Nent presje Tete qinde dhe Shtatedhjetë €**  
(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

**€ 12,229.87** siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen (shuma e garancisë) arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës **16.07.2018** deri më **12.12.2018**

Lëshuar në **PRISHTINE** datë **16.07.2018**

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit



PRISHTINE

0003374


# PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR


## PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Name	SABA BELCA DEGA NË KOSOVË
Emri	DRITON ETEMI
Adresa	Rruga e Llapit, Milloshevë
Qyteti	Obiliq
Kodi Postar	15050
Kontakti	049/396-874
Telefoni	044/301-444
Faksi	
E-mail	<a href="mailto:sababelca.kosove@gmail.com">sababelca.kosove@gmail.com</a>
Numri i TVSH	330320523

BANKA	
Name	PROCREDIT BANK SH.A
Emri	PROCREDIT BANK SH.A
Adresa	Rr. "Xhorxh Bush" Nr. 26
Qyteti	Prishtinë
Kodi Postar	10000
Shteti	Kosovë
Llogaria Bankare	1189006962000121
IBAN (opcionale)	XK051189006962000121
BIC (Opcionale)	

### SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAOËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)</u>


<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</u>
16.07.2018 

# PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Numri i Prokurimit: {614 18 028 521} – Titulli {Asfaltimi i rrugëve:Abdullah Querkezi,Albert Rama,Hamdi Krasniqi,Aziz Zhilivoda,Prapashtica,Mentor Dervishaj,Çajupi}

## SHËNIM

Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

## PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Për: { KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ }  
(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: {Asfaltimi i rrugëve:Abdullah Querkezi,Albert Rama,Hamdi Krasniqi,Aziz Zhilivoda,Prapashtica,Mentor Dervishaj,Çajupi}

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit:

< 614 18 028 521 >. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Objekti i kontratës nuk është i ndarë në pjesë Lot/

[Çmimi i tenderit në shifra: [ 122.298.71 ]  
shëno çmimin e tenderit në shifra



Dhe në fjalë [ Njëqind e njëzet e dymijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë Euro e shtatëdhjetë e një Cent ]

shëno çmimin e tenderit në fjalë]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej [60] nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës [ 10% ]

shëno vlerën ose përqindjen e sigurisë

6. Operatori Ekonomik kanë këtë nacionalitet:[Shqiptar]

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [“Saba Belça: Dega në Kosovë”]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se

45

B17 Dosjea e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur



Numri i Prokurimit: (814 18 925 511) – Titulli (Asfalumi) rrugëve: Abdullah Çerkezli, Albert Rama, Hamdi Krasniqi, Aziz Zalli odh. Prapa-shtica, Memov Dervishi, Çajupi

të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Në do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu në e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.

9. Thëksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

#### E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	"Saba Belça: Dega në Kosovë
ADRESA E PLOTE	RR, "E LLAPIT" MILLOSHEVE - OBILIQ
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	DRITON ETEMI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	22.06.2018
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vendësia
Partneri 1*	"SB Construction" SH.P.K	Milloshëve - Obiliq

\* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që në kontratë nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [Driton Etemi]

Nënshkrimi: 

Vendi dhe data: Obiliq 22.06:2018

Vula e Udhëheqësit:



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq Faza e II-të					
Rruga "Abdullah Qerkezi" Obiliq L=400.0m; (L <sub>1</sub> =185m B=5.0m dhe L <sub>2</sub> =215m B=4.0m)					
Nr	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	SHUMA
<b>I. PUNËT PËRGADITORE</b>					
Egzaminimi i materialeve dhe bazes së rruges para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. Zhavorit gypave dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përrardhjen e materialit.					
1.1	Të bëhet inçizimi i trasës dhe të bëhet pikëtimi në bazë të matjeve gjeodezike.	m'	400.00	0.20€	80.00 €
1.2	Matjet të cilat bëhen në teren, duhet të dorëzohen te Autoriteti Kontraktues në formë të Projektit të shtypur dhe elektronike (CD). Pas Përfundimit të punimeve duhet të dorëzohet projekti i egzekutimit.	m'	400.00	0.20€	80.00 €
1.3	Pastrimi i terrenit, gardhit, shkurreve, Lisave dhe të gjitha materialeve tjera të cilat gjenden në rrugë të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, Transporti i materialeve të grumbulluara gjatë pastrimit, duhet të transportohen deri në deponi 5km sipa Menaxherit të Kontratës.	m'	215.00	0.50€	107.50 €
<b>NËNTOTALI:</b>					<b>267.50 €</b>
<b>II. PUNËT TOKËSORE</b>					
2.1	Gërmimi i kombinuar i dheut në kat III dhe IV, pra heqja e shtresës së tokës deri te pjesa e fortë dhe të përgaditet për bazament të rrugës ,si dhe transporti i materialit deri në deponi.Dim 185x6x0.4m	m <sup>3</sup>	483.00	1.80 €	869.40 €
2.2	Gërmimi i kombinuar i dheut në kat III dhe IV, pra gërmimi i dheut për ta formuar skarpatën te pjesa e zgjerimit të rrugës dhe të përgaditet për bazament të rrugës ,si dhe transporti i materialit deri në deponi.Dim 150x1.0m Hmes=0.4m	m <sup>3</sup>	52.90	2.50 €	132.25 €
2.3	Pas të gjitha procedurave të gryerjeve, do të thot kur të formohet traseja e rrugës duhet të ngjeshet toka në nivel të duhur, para se të fillohet të punohet me zhavor.	m'	400.00	1.00 €	400.00 €
2.4	Furnizimi me xheotekstil(300g/m2) dhe shtruarja në tërë sipërfaqen e trasës së ngjeshur.	kg	655.50	1.00 €	655.50 €
<b>NËNTOTALI:</b>					<b>2,057.15 €</b>
<b>III. PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS</b>					
3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-150mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 20cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, dhe për çdo shtresë duhet të ujitet mirë, në mënyrë që të arrihet dendësia e kompaktimit të zhavorit. Dim 185x6x0.2m + 215x5x0.2m	m <sup>3</sup>	502.55	6.00€	3,015.30 €
2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-60mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 10cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, dhe për çdo shtresë duhet të ujitet mirë, në mënyrë që të arrihet dendësia e kompaktimit të zhavorit. Dim 185x6x0.1m + 215x5x0.1m	m <sup>3</sup>	251.28	6.00€	1,507.65 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 10cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, dhe për çdo shtresë duhet të ujitet mirë, në mënyrë që të arrihet dendësia e kompaktimit të zhavorit. Ngjeshja duhet të arrijë koficientin mbi 700KN/cm <sup>2</sup> .Dim 185x6x0.1m + 215x5x0.1m	m <sup>3</sup>	251.28	10.00€	2,512.75 €
Vërejtje:Matjet e modulit të ngjeshmëris i bën A.K,mirpo nëse rezultatet e kërkuara nuk arrihen atëhere O.E është i obliguar që vet ti hartë shpenzimet për matje tjera në këtë rrug parashihen të bëhen 5 matje.					
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion Ø 0-31 mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 8cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, dhe për çdo shtresë duhet të ujitet mirë, në mënyrë që të arrihet dendësia e kompaktimit të zhavorit.		38.40	12.00€	460.80 €
<b>NËNTOTALI:</b>					<b>7,496.50 €</b>

IV PUNËT E NGRITJES SË PUSËTAVE					
4.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusëtave të knalizimit, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusërat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusëtë dhe ngritja e pusëtës duhet të bëhet në mënyrë precize dhe të jetë barabart me Asfalt.	Copë	6.00	30.00€	180.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i kapakut të Pusëtës duhet të jetë me peshe mbajtëse nga materiali i gëzës mbi 45Ton.	Copë	6.00	115.00€	690.00 €
<b>NËNTOTALI:</b>					<b>870.00 €</b>
V PUNËT E ASFALTIT					
